



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 314 / 2017
Datë: 14 qershor 2017

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 4 paragrafi 1.14 dhe nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 14 qershor 2017, mori këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet kërkesa e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, për vazhdimin e transferit të përkohshëm të prokurorit Arben Ismajli për një periudhë (6) mujore, nga data 5 korrik 2017 deri më 4 janar 2018.
- II. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim, ta publikojë në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore Ferizaj z.Shkuri Jashari, i është drejtuar me kërkesë Këshillit Prokurorial të Kosovës, për vazhdimin e aftatit të transferit edhe për 6 muaj të prokurorit Arben Ismajli në këtë prokurori. Fillimisht Kryeprokurori i Shtetit z. Aleksandër Lumezi ka marrë vendim Nr.202/2017 të datës 30 maj 2017, me të cilin ka transferuar përkohësisht prokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjilan z. Arben Ismajli në departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, për një periudhë prej 30 ditë, nga data 5 qershor 2017 deri me datë 4 korrik 2017.

Kryeprokurori Shkuri Jashari ka vlerësuar se periudha prej 30 ditëshe e transferit është mjaftë e shkurtër andaj për të arritur qëllimin që t'i ofrojë ndihmë prokurorisë së Ferizajit, përkatësisht departamentit për Krime të Rënda, kur dihet numri i madh i lëndëve dhe mungesa e prokurorëve në këtë departament, ka kërkuar vazhdimin e transferit edhe për 6 muaj.

Këshilli Prokurorial i Kosovës duke u bazuar në kërkesën e Kryeprokurorit Jashari, dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale në këtë prokurori, e cila ballafaqohet me mungesën e vazhdueshme të prokurorëve e sidomos të departamentit për Krime të Rënda, me qëllim që të sigurojë funksionalitetin të kësaj prokurorie, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Blerim Isufaj
Kryesues i Këshillit Prokurorial

T'i dërgohet:

- Kryeprokurorëve të PTH Ferizaj dhe PTH Gjilan;
- Z. Arben Ismajli;
- Sekretariatit dhe NJSHPP;
- Divizionit të Burimeve Njërzore;
- Arkivit të KPK-së.